



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Data 12/02/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje ushqime për kopsht dhe çerdhe për vitet 2026 –  
2028"**

- Loti I Blerje Bukë integrale ose thekre
- Loti II Blerje Mish Viçi i freskët
- Loti III Blerje Bulmetore.
- Loti IV Blerje Ushqimore
- Loti V Blerje Fruta-Perime

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
Ushqim për fëmijë 15884000-8, Ushqime për shkollë 15894210-6**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **6,524,250 (gjashtë milion e pesëqind e njëzet e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë** pa TVSH venë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2026, 2027 dhe 2028, për objektin: **"Blerje ushqime për kopsht dhe çerdhe për vitet 2026 - 2028"**, sipas viteve si më poshtë:

- Loti I Blerje Bukë integrale ose thekre me vlerë 498,333.4 lekë pa Tvsh.
- Loti II Blerje Mish Viçi i freskët me vlerë 1,124,999.9 lekë pa Tvsh.
- Loti III Blerje Bulmetore me vlerë 2,562,500.1 lekë pa Tvsh.
- Loti IV Blerje Ushqimore me vlerë 1,540,291.7 lekë pa Tvsh.
- Loti V Blerje Fruta-Perime me vlerë 798,124.9 lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **- Loti I Blerje Bukë integrale ose thekre me vlerë 498,333.4 lekë pa Tvsh.**

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqes xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor këstet e maturuara për vitin 2026, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e

taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

*Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, vetëm njërin prej llojeve të dokumentave të përcaktuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

- 2.3.2. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që produktet e kërkuara plotësojnë standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

#### **ARGUMENTIM:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të produkteve objekt prokurimi.

Gjithashtu Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën g të seksionit III të rekomandimit e përbashkët të APP dhe AKU Nr. 10181 Prot. Datë 19.11.2018 ”Për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit”.

- 2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vetëdeklarim ku të deklarojë se transportimi i produkteve objekt prokurimi do të realizohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontrator Bashkia Patos në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, nga operatori ekonomik me automjetet e shoqërisë nëpër magazinat kopshtit dhe cerdhes. Automjetet e përdorura për transportin e produkteve duhet të jenë brenda kushteve higjieno-sanitare. Duhet të vetëdeklarojë gjithashtu se amballazhimi për çdo produkt të jetë brenda kushteve higjieno-sanitare.

#### **ARGUMENTIM:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “**Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu edhe bazuar në pikën 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe

garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të produkteve objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme:

Liçencë të leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit Kodi II.1.A (1) Prodhim, përpunim shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe bazuar në Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet Në Republikën E Shqipërisë”, Shtojcë e ligjit "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", parashikohet:

*Fusha II.*

*Ushqimi dhe Shëndeti*

1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve
  2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinarë
  - 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve
  4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve
  5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve
  6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë
  7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.
  8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare
- Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, parashikohet:

*FUSHA II*

*USHQIMI DHE SHËNDETI*

*KATEGORIA II.1*

*PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE*

*I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME*

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”
2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

**a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;**

**b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;**

**c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.**

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

## II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A

5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.

6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:

a) **“Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me kodin II.1.A.1.**

b) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.2.

c) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.3.

7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin me sukses kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 4 (katër) – persona që të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajn e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, ku nga këta 2 (dy) duhet të jenë shoferë të pajisur me lejet e drejtimit, si dhe 2 (dy) punonjës ndihmës të pajisur me librezat shëndetësore, për shpërndarjen e ushqimeve në ambientet e caktuara prej autoritetit kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Numri prej **4 (katër)** punonjës është përlllogaritur referuar furnizimit të mallrave objekt prokurimi që do të kryejë operatori ekonomik fitues me qëllim realizimin e këtij shërbimi për një periudhën 36 mujore duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë në pronësi ose në përdorim ose me kontratë furnizimi noteriale Furrë buke të pajisur me çertifikatë pronësie, me leje higjieno sanitare, licensë QKL me Kodin II.1.A.(1) si dhe Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri. Për produktin e mësipërm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/me qera ose kontratë përdorimi duhet që të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi/ ose kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: liçensë, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon që

operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën me sukses dhe në kohë.

**Njësia e prokurimit** mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke analizuar preventivin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi, parashikohen ato zëra ku disponueshmeria e **Magazinës ushqimore dhe ambiente frigoriferike, Thertores, Kompleks stallor, Furrë buke, Serë, Kompleks pularie dhe Njësi prodhimi bulmeti** lidhet drejtëpërdrejtë me zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë si dhe me preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor, duke garantuar këtë të fundit për vazhdimësinë e tyre në mënyrë të pandërprerë.

Autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, është në të drejtën e tij të kërkojë nga ofertuesit në lidhje me kapacitetin e tyre teknike për përmbushjen me sukses të zbatimit të kontratës, dhe për rrjedhojë të kërkojë garanci nga operatorët ekonomik për mënyrat se si do furnizohet AK për çdo zë të parashikuar tek preventivi i furnizimit të mallrave objekt prokurimit.

2.3.7 Operatorët ekonomik ofertues duhet të operojnë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ata duhet të **paraqesin vetëdeklarim** ku të deklarojnë se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacion provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën me sukses dhe në kohë.

*Si dhe referuar Rekomandimit të përbashkët Nr.10181 Prot, APP dhe Nr. 8514 Prot, AKU, gërma "g" e seksionit III "Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim", ku përcaktohet se: "Në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, autoriteti kontraktor duhet të mbaje në konsideratë që: Duhet plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesi vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

### **2.3.8 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë dhe paraqesin çertifikatën sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

1. Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të autokontrollit, bazuar në parimet (**UNI 10854:99 HACCP**) *ose ekuivalent*.
2. **ISO 22000:2018** (Çertifikatë sipas konformitetit me standartet evropiane për menaxhimin e sigurisë ushqimore) *ose ekuivalent*.
3. **ISO 9001:2015** (Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë) *ose ekuivalent*.

**Argumentim:** Në bazë të dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

## **- Loti II Blerje Mish Viçi i freskët me vlerë 1,124,999.9 lekë pa Tvsh.**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqes xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% te fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor këstet e maturuara për vitin 2026, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e

aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, vetëm njërin prej llojëve të dokumentave të përcaktuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë për “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (*nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018*).

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për realizimin e kontrates kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Duke qene se keto lloj produktesh te ketij loti jane me specifike n eruajtjen dhe tregtimin e tyr enga AK kekrohet minimalisht kjo licence.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme:

- Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit Kodi II.1.B, Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz),
- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe bazuar në Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet Në Republikën E Shqipërisë”, Shtojcë e ligjit "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", parashikohet:
  - *Fusha II.*
  - *Ushqimi dhe Shëndeti*
  - *1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve*
  - *2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare*
  - *3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve*
  - *4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve*
  - *5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve*
  - *6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë*
  - *7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.*

- 8. *Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjiëno-sanitare*
- 
- Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, parashikohet:
  - *FUSHA II*
  - *USHQIMI DHE SHËNDETI*
  - *KATEGORIA II.1*
  - *PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE*
  - *I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME*
  - *1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*
  - *2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:*
    - ***a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;***
    - ***b) “Shtitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;***
    - ***c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.***
  - *3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*
  - *4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.*
- *II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A*
  - *5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.*
- *6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:*
  - ***a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me kodin II.1.A.1.***
  - *b) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.2.*
  - *c) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.3.*
- *7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 .*

Si dhe referuar Rekomandimit të përbashkët Nr.10181 Prot, APP dhe Nr. 8514 Prot, AKU, gërma "a" dhe "a.I" e seksionit III "Hartimi i kriterëve të vecanta për kualifikim", ku përcaktohet

se: "Ne hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë që:

- a) Në objektet e prokurimit për prodhim/përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë Liçencë, kategoria II.1.A.1 "

Për sa më sipër, nisur nga argumentimi i njësisë së prokurimit si dhe referuar legjislacionit të fushës përkatëse, konstatohet se për veprimtarinë shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) është i domosdoshëm **kodi II.1.B**, për Prodhim, përpunim shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz është i domosdoshëm **kodi II.1.A (1)**, si dhe për produkte bujqësore është i domosdoshëm **kodi II.1.C**.

2.3.4 Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që produktet e kërkuara plotësojnë standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore.

#### **ARGUMENTIM:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të produkteve objekt prokurimi.

Gjithashtu Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën g të seksionit III të rekomandimit e përbashkët të APP dhe AKU Nr. 10181 Prot. Datë 19.11.2018 "Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit".

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vetëdeklarim ku të deklarojë se transportimi i produkteve objekt prokurimi do të realizohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, nga operatori ekonomik me automjetet e shoqërisë nëpërmjet magazinat kopshtit dhe cerdhes. Automjetet e përdorura për transportin e produkteve duhet të jenë brenda kushteve higjieno-sanitare. Duhet të vetëdeklarojë gjithashtu se Amballazhimi për çdo produkt të jetë brenda kushteve higjieno-sanitare.

#### **ARGUMENTIM:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "**Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu edhe bazuar në pikën 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të produkteve objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin me sukses kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 4 (katër) – persona që të figurojnë në listëpagesat e shoqërise për të paktën muajn e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, ku nga këta 2 (dy) duhet të jenë shoferë të pajisur me lejet e drejtimit, si dhe 2 (dy) punonjës ndihmës të pajisur me librezat shëndetësore, për shpërndarjen e ushqimeve në ambientet e caktuara prej autoritetit kontraktor.

***Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

***Argumentim:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 2 (dy) mjete transporti, nga të cilat 1 (nje) mjet transporti frigoriferik ATV për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (çertifikatë pronësie ose kontratë qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me lejen higjeno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit).

***Argumentim:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë në pronësi **ose** në përdorim **ose** me kontratë furnizimi noteriale **Thertore** të pajisur me leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (therje kafshësh), Liçense lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore).

Për produktin e mësipërm në rastin kur operatorin nuk e ka në pronësi/qera ose në përdorim duhet që të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi/ ose kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si liçensë, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

***Argumentim:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën me sukses dhe në kohë.

2.3.8 Operatorët ekonomik ofertues duhet të operojnë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ata duhet të **paraqesin vetëdeklarim** ku të deklarojnë se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacion provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën me sukses dhe në kohë.

*Si dhe referuar Rekomandimit të përbashkët Nr.10181 Prot, APP dhe Nr. 8514 Prot, AKU, gërma "g" e seksionit III "Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim", ku përcaktohet se: "Në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, autoriteti kontraktor duhet të mbaje në konsideratë që: Duhet plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesi vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli I fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

### **2.3.9 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë dhe paraqesin çertifikatën sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të autokontrollit, bazuar në parimet (**UNI 10854:99 HACCP**) *ose ekuivalent.*
- b) **ISO 22000:2018** (Çertifikatë sipas konformitetit me standartet evropiane për menaxhimin e sigurisë ushqimore) *ose ekuivalent.*
- c) **ISO 9001:2015** (Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë) *ose ekuivalent.*

**Argumentim:** Në bazë të dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

## **- Loti III Blerje Bulmetore me vlerë 2,562,500.1 lekë pa Tvsh.**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqes xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor këstet e maturuara për vitin 2026, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

*Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e*

*aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

### **2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, vetëm njërin prej llojeve të dokumentave të përcaktuara.
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë për “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për realizimin e kontratës kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Duke qenë se keto lloj produktesh të këtij loti janë me specifike në ruajtjen dhe tregtimin e tyre nga AK kërkohet minimalisht kjo licence.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme:

- Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit Kodi II.1.B, Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz),

*(nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe bazuar në Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet Në Republikën E Shqipërisë”, Shtojcë e ligjit "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", parashikohet:

*Fusha II.*

*Ushqimi dhe Shëndeti*

1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve
2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare
- 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve
4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve
5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve
6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë
7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.
8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjierno-sanitare

Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, parashikohet:

*FUSHA II*

*USHQIMI DHE SHËNDETI*

*KATEGORIA II.1*

*PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE*

*I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME*

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

**a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;**

**b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;**

**c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.**

